



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 dhjetor 2016
Nr. ref.:RK1016/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI79/16

Parashtrues

Sabit Gori

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 302/2015, të 3 nëntorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sabit Gori, me banim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Shemsi Uka, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 302/2015, i 3 nëntorit 2015, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 5 shkurt 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 302/2015, i 3 nëntorit 2015. Parashtruesi pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta janë shkelur: neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 maj 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 23 qershor 2016, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme.
8. Më 20 tetor 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 15 shkurt 2001, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Komunës së Prishtinës, ku kërkoi vërtetimin e pronësisë në ngastrën kadastrale e cila është e evidentuar me nr. 220/1.
10. Më 30 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 59/01), refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit. Më tutje, në Aktgjykim theksohet “[...] pabazueshmërinë e kërkesëpadisë gjykata e mbështeti në faktin se paditësi nuk arriti ta provojë se ai vërtetë pas një procedure të rregullt administrative e ka blerë nga e paditura parcelën kontestuese [...] gjykata përkujton se

dipozitat e ligjit për marrëdhëniet themelore pronësore juridike, i cili është aplikuar në kohën e lidhjes së kontratës së pohuar, ka përjashtuar të drejtën e pronësisë për sendet në pronësi shoqërore [...]”.

11. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës ndaj Aktgjykimit C. nr. 59/01, të 30 korrikut 2013, të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
12. Më 14 prill 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 3004/2013), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit duke vërtetuar në tërësi qëndrimin e Gjykatës Themelore.
13. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3004/2013, të 14 prillit 2015.
14. Më 3 nëntor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi, Rev. nr. 302/2015), refuzoi si të pabazuar revizionin.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, respektivisht neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].
16. Lidhur me nenin 24 [Barazia para Ligjit], parashtruesi pretendon se *“[...] nuk ka pas barazi para gjykatave, sepse të gjitha aktgjykimet janë të bazuara në të vetmin arsyetim se: ‘kinse nuk janë ndjekur procedurat e ankandit publik’, kur është çështja e pasurisë së Komunës, ndërsa dëshmia e dëshmitarëve si provë në procedurë as që është marrë parasysh fare”.*
17. Parashtruesi lidhur me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] pretendon se *“e drejta për gjykim të drejtë është shkelur me faktin se paditësi është në posedim dhe shfrytëzim të papenguar të paluejtshmërisë kontestuese edhe atë fillimisht si qiraxhi prej vitit 1993 deri në vitin 1997, kurse prej vitit 1997 e deri më sot edhe si pronar dhe posedues i ligjshëm dhe me mirëbesim”.*
18. Më tutje, parashtruesi pretendon se është shkelur neni 46 [Mbrojtja e Pronës], duke theksuar *“neni 46 i Kushtetutës është shkelur sepse paditësit i është mohuar e drejta e pronësisë [...] me asnjë aktgjykim nuk është përfillë, pra edhe përkundër fakteve dhe provave të sipërtheksuara, si dhe të gjitha atyre që gjenden në shkresat e lëndës, ato nuk janë vlerësuar drejt dhe plotësisht [...]”.*
19. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata:

“Prishjen e të gjitha aktgjyqimeve të gjykatave dhe kthimin e çështjes për rigjykim dhe vendosje meritore”.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

(...)

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

22. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij ta qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

23. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(...)

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

24. Në kërkesën e tij, parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 302/2015, të 3 nëntorit 2015, me të cilin atij i është refuzuar kërkesa për vërtetimin e pronësisë.

25. Në lidhje me shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit], Gjykata konstaton se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe as nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për trajtim të pabarabartë. Kur pretendohet një shkelje e tillë kushtetuese, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë një pretendim të arsyetuar dhe argument bindës.

26. Gjykata konstaton se parashtruesi nuk ka treguar se është trajtuar ndryshe në krahasim me mënyrën se si do të ishin trajtuar individë të tjerë në të njëjtën situatë. Në mënyrë që një çështje të jetë diskriminuese, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata të ngjashme. Një ndryshim i trajtimit është diskriminues nëse nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm; me fjalë të tjera, në qoftë se ajo nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet (Shih rastin *Burden kundër MB* [DHM] nr. 13378/05, GJEDNJ, aktgjykim i 29 prillit 2008).
27. Lidhur me shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], parashtruesi nuk arriti të japë ndonjë arsyetim se si dhe pse e drejta e tij për gjykim të drejtë është shkelur nga gjykatat e rregullta.
28. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet arsyetimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, si përgjigje ndaj pretendimeve të parashtruesit për “*shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe paraqitjes së provave të reja*”. Gjykata Supreme në arsyetim theksoi “*në rastin konkret nuk janë përmbushur kriteret e parapara me ligjin në fuqi, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në favor të paditësit mbi paluejtshmërinë kontestuese e cila evidentohet si ngastër kadastrale 220-1, në kuptim të dispozitës së nenit 4 par. 4 të Ligjit mbi Qarkullimin e Paluajtshmërisë (GZ e RSS nr. 40/89) për arsye se paluejtshmëria kontestuese nuk është fituar në kufij të ligjit [...]. Paditësi ka dështuar të provojë faktin se janë plotësuar kushtet ligjore nga paragrafi 4 i Ligjit të lartcekur, për të pranuar efektet juridike të kontratës mbi shitblerjen [...]*”.
29. Në lidhje me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], parashtruesi pretendon se “*neni 46 i Kushtetutës është shkelur sepse paditësit i është mohuar e drejta e pronësisë [...] me asnjë aktgjykim nuk është përfillë, pra edhe përkundër fakteve dhe provave të sipërtheksuara, si dhe të gjitha atyre që gjenden në shkresat e lëndës, ato nuk janë vlerësuar drejt dhe plotësisht [...]*”.
30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk është bërë bartës i të drejtës pronësore, përkundrazi Gjykata vëren se Gjykata Themelore e ka trajtuar bazën e posedimit të ngastrës: “*Nga urdhri i datës 27.10.2000 rezulton se Administratori komunal i UNMIK-ut në Prishtinë dhe Drejtori i Departamentit për kadastrë dhe gjeodezi e kanë urdhëruar paditësin që në afat kohor prej tre ditësh ta lirojë pronën shoqërore [...] pasi që është duke u përdorur pa bazë ligjore [...]*”. Prandaj, kjo gjendje juridike „nuk mund të konsiderohet si “pronë” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1”.
31. Gjykata vëren se të gjitha pritjet e tij se do të fitojë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronës janë hedhur poshtë nga gjykatat e rregullta.
32. Parashtruesi pretendon se është shkelur neni 54 [Mbrojtjen Gjyqësore të të Drejtave], parashtruesi thjesht i është referuar nenit përkatës të Kushtetutës, pa ofruar ndonjë arsyetim të mtejshëm se si dhe pse i është shkelur kjo e drejtë nga Gjykata Supreme.

33. Gjykata vëren se parashtguesi i kërkesës kërkon: “*Prishjen e të gjitha aktgjykimeve të gjykatave dhe kthimin e çështjes për rigjykim dhe vendosje meritorë*”.
34. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
35. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës* Nr. 30544/96, ECHR, aktgjykim i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtgues: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011). Fakti se parashtguesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk ngre një pretendim të argumentuar për shkelje të të drejtave të tij, të mbrojtura me Kushtetutë.
36. Gjykata vëren se parashtguesi ka pasur mundësi ta prezantojë rastin para gjykatave të rregullta. Çështja, se pse parashtguesit të kërkesës i është refuzuar kërkesa për vërtetimin e pronësisë është trajtuar gjerësisht nga Gjykata Themelore, nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme. Kjo e fundit i është përgjigjur të gjitha pretendimeve të parashtguesit, duke potencuar faktin se kontrata mbi shitblerjen, në bazë të së cilës parashtguesi pretendon ta fitojë të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale, nuk mund të krijojë efekte të vlefshme ligjore për miratimin e kërkesëpadisë, për shkak se kontrata e tillë, nuk i plotëson kërkesat ligjore për validitetin e saj.
37. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se Gjykata Kushtetuese mund vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë korrekte dhe nëse në përgjithësi procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtguesi kishte një gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
38. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi lidhur me refuzimin e të drejtës së pronësisë në ngastrën kadastrale në aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë, dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata, gjithashtu ka gjetur se procedurat pranë Gjykatës Themelore dhe pranë Gjykatës së Apelit nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
39. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se parashtguesi ka dështuar të mbështesë pretendimet e tij lidhur me atë se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tij nga Gjykata Supreme.

40. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) (d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 20 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Arta Rama-Hajrizi

